



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 10/15

Prishtinë, më 12.3.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Bardhyl Meta dhe Fikrim Damka.

Munguan: Visar Ymeri, Bojan Mitić, Donika Kada-Bujupi dhe Enver Hoti.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

1. Rishqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2015;

Kryetari - në mbledhjen e kaluar jemi përqendruar në shumë çështje të ndryshme dhe si rezultat është krijuar nevoja për këtë mbledhje të sotme, tema kryesore do të jetë çështja e pagave të bordit të Trustit. Duke konsideruar që paga e bordit nuk është ndryshuar që nga viti i 2002 në kalkulim del që paga e anëtarëve të bordit është 1,250 euro bruto dhe kjo shumë është në përputhje me nivelin e pagave të agjensioneve tjera. Jemi në situatë që nuk ka disponim prej deputetëve për të aprovuar rritjen e pagave të bordit për arsye se me kërkesën e tyre del që paga të jetë 1,833 euro. Prandaj, propozimi është që në emër të zvogëlimit të kompensimeve për anëtarët e bordit të FKPK-së, të ndryshohet rekomandimi i Komisionit, i proceduar në seancë dhe të dërgohet një rekomandim i ri, dhe në pikën e parë të rekomandohet që taksa operationale të miratohet prej 0,085% nga 0,087%, se ka qenë propozuar më herët. Ndërsa taksa investive të mbetet e pandryshuar, siç është rekomanduar prej 0,40%. Zvogëlimi i taksës operationale ndikon në mënyrë që të mos ketë rritje të kompensimit të anëtarëve të bordit, siç është planifikuar nga Fondi. Nuk do të ketë mungesë të mjeteve që e pengon operimin e punës së Fondit. Ndërkaq, mendojë se njëherë e përgjithmonë duhet me përfundue çështje e hartimit të ligjit për paga të funksionarëve të lart, dhe shpresoj që kjo do të ndodhë këtë vit.

Safete Hadergjonaj – me kujtohet që takimin e parë e diskutimit për taksën operationale dhe investive e kam kundërshtuar rritjen të kompensimit të bordit, siç e kanë kundërshtuar edhe anëtarët e tjerë të komisionit. Ndërsa në takimin ditën e dytë, kam ardhur me vonesë në takim për shkak obligimeve tjera dhe nuk e kam parë se kjo çështje e kompensimit të bordit është përsëritur në kërkesën e dytë. Unë e

përkrahi ndryshimin e takses operacionale në 0.085%. Po ashtu jam shumë e interesuar për hartimin e Ligjit për pagat e funksionarëve të lartë, në mënyrë që ne mos të merremi më me këtë problem. Megjithatë nëse nuk ka disponim me ardhur ligji nga qeveria, për këtë çështje do të kërkoj që kryetari i komisionit për buxhet dhe financa dhe komisioni për administratën publike, ta marrim iniciativën për hartimin e ligjit.

Latif Gashi – ka qenë e duhur që në takim të theksohet çështja e kompensimit të bordit se në mbledhjen e kaluar nuk është theksuar mjaft. Grupi parlamentar i Partisë Demokratike nuk e ka përkrahë rritjen e kompensimit të bordit. Mbledhja e sotme është e duhur për arsye se duhet të theksohet se nuk ka rritje të kompensimit për bordin e Trustit dhe e përkrahi taksen operacionale për 0.085%.

Kryetari – kërkohet një votim formal për taksen operacionale në 0.085% që rezulton si pengesë e realizimit të rritjes së kompensimit të bordit dhe pastaj të dërgojmë rekomandimin e ri të Komisionit për seancë.

Labinote Demi-Murtezi – a duhet me informuar Trustin për këtë ndryshim.

Kryetari – ne bisedova me drejtorin e Trustit për çështjen e kompensimeve dhe si rezultat ata kanë qenë të gatshëm të propozojnë taksen operacionale për 0.085%, në mënyrë që të mos ketë rritje në kompensimet e bordit.

Pas diskutimeve dhe propozimit, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që të tërheq rekomandimin e datës 4.3.2015 të proceduar në seancën plenare dhe nxori rekomandimin e ri si në vijim këtë

Rekomandim

1. Të miratohet kërkesa e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për taksen operacionale prej 0,085% dhe taksen investive prej 0,40%, për vitin 2015.
2. Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës, suficitin e akumuluar nga aktivitetet investuese, në vlerë prej 870,000 (tetëqind e shtatëdhjetë mijë) Euro, të kthejë në llogaritë individuale të kontribuuesve në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në ora 11:07

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani